

Fabio M. Rocchi

Ur-Muzika e Ismail Kadare. Mbi një studim tematik të Profesor Vasil S. Tole.

Ekzistojnë disa libra, që edhe pse i lexon kohë pas publikimit të tyre, meritojnë analiza të thella dhe reflektime mbi përmbajtjen që kanë shpalosur.

Është padyshim ky rasti i librit të Vasil Toles - *Kadare dhe Muzika*, Mediaprint, Tiranë 2019 – në të cilin autori heton marrëdhënien mes shkrimtarit të madh shqiptar dhe botës së pasur të traditave folklorike. Bëhet fjalë për një marrëdhënie të ndjerë, e ushqyer nga instinkti dhe trashëgimia kulturore stërgjyshore, duke qenë se Kadare nuk ka një kulturë muzikore teknike të mirëfilltë, e parë kjo në kuptimin e një eksperti të fushës, por është i pajisur me gjithë atë bagazh perceptimesh të jashtëzakonshme që vetëm një artist i madh është i aftë të zotërojë.

Deri në momentin e botimit të librit në fjalë, para tri vitesh, në bibliografi mungonte një studim i këtyre përmasave. Edhe pse sekuenca e librave dhe shkrimeve kritike mbi Kadarenë ishte e pafundme, akoma nuk ishte kryer një analizë shkencore e mirëstrukturuar mbi këtë temë, në gjendje të veçante disa konstante që do të viheshin më vonë në relacion me muzikën.

Pra, libri është interesant si nga pikëpamja muzikologjike, po aq nga ajo e kritikës leterare. Përgjatë trembëdhjetë kapitujve kushtuar aspekteve qëndrore mbi raportin mes Kadaresë dhe arketipeve isopolifonikë të këngës popullore të Shqipërisë së Jugut, hasen të paktën tri shtylla të cilat, sipas këndvështrimit tim, duhen theksuar:

- a. Tingulli si metafizikë e botës;
- b. Origjina e tragjedisë dhe raporti me vajtimin mortor;
- c. Koncepti i njeriut-këngë.

Do të përpiqem të trajtoj shkurtimisht secilën prej këtyre pikave, duke iu referuar reflektimeve të hollësishme të shoqëruara me shembuj në trajtimin e Tole.

Tingulli si metafizikë e botës.

Konstatimi i parë i rëndësishëm që bëhet duke lexuar monografinë e Toles, ka të bëjë me aftësinë e Kadaresë për të hyrë në empati, në mënyrë totalisht shpirtërore dhe irracionale mund të themi, me botën e tingujve qiellorë dhe atyre tokësorë, sipas vizionit të filozofisë antike orientale. Për këtë arsye, është e mundur të flitet në veprat e Kadaresë për një *ur-muzikë*, një muzikë me origjinë totalisht primitive dhe të rrënjosur thellë brenda, me të cilën shkrimtari gjirokastrit hyn në kontakt. Tole sjell disa shembuj shumë domethënës, të marrë nga romanet *Pallati i ëndrrave* dhe *Kështjella* (fq. 50-56).

Pikërisht nga ky i fundit kuptojmë rëndësinë e përdorimit të daulles në disa rituale dhe momente njerëzore, në të cilat, për të nënvizuar gjendje shpirtërore të caktuara apo situata të vështira për tu shprehur me fjalë të thjeshta, evokimi i një tingulli primitiv i vjen në ndihmë Kadaresë për përshkrimin e një situatë narrative më realiste dhe më dramatike në të njëjtën kohë. Nëse është e vërtetë që letërsia është arti i fjalës – pra e logosit dhe e arsyes – dhe, në krah të kundërt, muzika është arti i tingujve – pra e instiktit dhe e së pathënës – këtu dy hemisferat takohen, duke gjetur një pikë drejtpeshimi.

Origjina e tragjedisë dhe raporti me vajtimin mortor.

Tole, përpos tjerash, ka dashur të analizojë të gjithë prodhimtarinë e Kadaresë nga një perspektivë etnografike, duke reflektuar mbi një pikë vendimtare: atë që fillon nga praktikat dhe ritet mortore dhe shkon deri në lindjen e tragjedisë si gjini e lashtë e shfaqjes skenike. Del në pah një traditë komplekse, që ka rrënjë mijëvjeçare në qytetërimin e popujve në kufijtë mes Greqisë dhe Ballkanit. Është i vetëdijshëm edhe vetë Kadare, kur flet në studimin *Eskili ky humbës i madh*, ku përshkruan ritet e vajtimit në ceremonitë mortore, duke pohuar se me kalimin e kohës ishin organizuar në recitale të mirëfillta.

Në këto pika, Kadare rindërton ritualitetin e një vajtimi të kodifikuar dhe e lidh me ceremonialitetin e gjinisë tragjike, për të cilën grekët ishin frymëzuar nga traditat e lashta të territoreve fqinje.¹ Pra, ekziston një raport shumë i qartë mes këtyre formave të vajtimit dhe lindjes së tragjedisë, raport që ndikon veçanërisht funksionin e korit. Në ndërtimin e këngës polifonike me disa shtresa gjejmë një nga gjurmët më të qarta të një tradite mijëvjeçare. Jo më kot, isopolifonia, pas një procesi pastrimi nga forcimet politiko-ideologjike të pjesës së dytë të shekullit të njëzetë, në vitin 2005 u shpall pasuri e UNESCO-s.²

Kjo veçanti e natyrës folklorike është trajtuar edhe nga Floresha Dado në librin e saj *Eseistika e Kadaresë*, ku flet pikërisht për marrëdhënien që krijohet në eseistikën e Kadare mes trupit, artit dhe dimensionit mitik.³

Origjina jugore e Kadaresë ka mundësuar në njëfarë mënyrë afrimin e tij me këtë raport, nëpërmjet traditës gojore të këngëve popullore. Jo vetëm elementi dionizian por edhe teknika e vajtimit dhe formalizimi i saj në një prezantim para-teatral do të kishin përcaktuar lindjen e zhanrit tragjik. Në rekuperimin e atmosferave dhe tingujve të origjinës, qyteti i Gjirokastrës shfaqet si *qyteti i vajtimeve*, siç e përkufizon Tole (fq. 82). Në këtë mënyrë, ambienti i vendlindjes do të kishte përfaqësuar një habitat natyral për reflektimin e Kadaresë mbi këtë çështje.

Koncepti i njeriut - këngë

Për sa i përket ambientit ngushtësisht letrar, ekziston një koncept, në vetvete abstrakt, por, në të njëjtën kohë, shumë mahnitës, që përqëndrohet rreth figurës së rapsodit dhe që gjen vend në disa përshkrime narrative të Kadaresë, sidomos në veprën *Tri kënge zie për Kosovën*. Ja si shprehet Tole në lidhje me këtë, një një kalim që meriton të citohet i plotë:

«Eshtë një klasifikim popullor që lidhet me meritën e njeriut, parë nga sytë, mendja dhe zemra e popullit. Zakonisht jemi mësuar me ndarjen dhe klasifikimet e rëndësisë së njerëzve sipas shtresave shoqërore dhe titujve aristokratikë që mbajnë, si p. sh.: baron, dukë, kont, princ, mbret etj. apo me klasifikime dhe tituj të gradeve akademike, ushtarake apo fetare. Por ka edhe një ndarje tjetër, të pa shkruar dhe pa vendime e shkresa, ajo e popullit që flet për “njerëz me këngë”. Për popullin këto janë kategoria e njerëzve të shquar dhe është e kuptueshme që

deri sa ka njerëz me këngë, ka edhe njerëz pa këngë, madje shumica nuk ka këngë» (faqe 109).

Me këtotribute, Toles, studiues i folklorit dhe muzikës shqiptare dhe ballkanike,⁴ veçon figurën e rapsodit duke i atribuar, nëpërmjet zërit popullor, karakteristika pothuajse magjike, dhe, mbi të gjitha, të lidhura me sferën instiktive të qenies njerëzore.

Në përfundim, monografia e Toles hap një rrugë të re, alternative, për studimin e veprës së Kadaresë: atë të konstanteve tematike dhe të përmbajtjeve të zgjedhura në mënyrë transversale nga disa vepra, vepra që mund të jenë shumë të largëta si vite apo mënyrë të shkruari.

Në fakt, deri tani, studimi i prodhimit të gjerë kadareane është përqëndruar kryesisht rreth një perspektive storiografike – ajo që ndan përvojën e Kadaresë në periudha të ndryshme. Ndërsa analiza e Toles na tregon që është e mundur të veçohet një makro-temë dhe të verifikohet zhvillimi i saj duke bashkuar aspekte, në pamje të parë pa lidhje, të mendimit të autorit.

Përkthimi nga italishtja nga Kriselda Beqaj

Citime:

1 KADARE, Ismail, *Eschilo, il grande perdente*, përkthim nga shqipja i Adriana Prizreni, Besa, Nardò (Lecce) 2013, fq. 21-26 e fq. 87-101.

2 Mbi itinerarin e një asemi të vërtetë, shiko MINGA, Mikaela, *Praktika shumëzërëshe në Shqipëri dhe itineraret e një asemi kulturor*, në «Shejzat», n. 3-4, 2017, fq 5-17.

3 DADO, Floresha, *Lexuesi “në kurth”*: *Eseistika e Kadaresë*, Onufri, Tiranë 2016, fq. 150-151.

4. TOLE, Vasil S., *Folklor Muzikor. Iso polifonia dhe monodia*, Uegen, Tiranë 2007

Bibliografi e shkurtër

DADO, Floresha, *Lexuesi “në kurth”*: Eseistika e Kadaresë, Onufri, Tiranë 2016

HYSI, Fatmir, *Dy kohë dhe identiteti evropian i shqiptarëve*, Uegen, Tiranë 2008

MINGA, Mikaela, *Praktika shumzëreshe në Shqipëri dhe itineraret e një asemi kulturor*, në «Shejzat», nn. 3-4, 2017, fq 5-17

SINANI, Shaban, *Mite dhe demonë në veprën e Kadaresë*, Naimi, Tiranë 2016

SOKOLI, Ramadan, *Vallet dhe muzika e të parëve*, Print Book Albanian, Tiranë 1971

TOLE, Vasil S., *Muzika dhe Letërsia*, Onufri, Tiranë 2007

TOLE, Vasil S., *Folklor Muzikor. Iso polifonia dhe monodia*, Uegen, Tiranë 2007

Linkografi

Agron Fico, *Në korpusin letrar të Kadaresë romani “Kronikë në gur” e afirmoi si shkrimtar dhe Gjirokastrën e futi në hartën e botës. Sfidë shkencore nga Vasil Tole, kënga, Lordi dhe Çështja Homerike*

[<http://telegraf.al/analize/kadare-dhe-muzika-prof-dr-agron-f-fico-ne-korpusin-letrar-te-kadarese-romani-kronik-ne-gur-e-afirmoi-si-shkrimtar-dhe-gjirokastren-e-futi-ne-harten-e-botes-sfida-shkencore-nga-vasil-tole-ken/>]

Shaban Sinani, *Për librin "Kadare dhe Muzika"*

[<http://www.gsh.al/2019/06/25/disa-shenjime-per-librin-kadare-dhe-muzika-te-vasil-s-toles/>]

Edison Ypi, *Për librin "Kadare dhe Muzika"*

[<https://shqiptarja.com/lajm/edison-ypi-libri-degjohet>]

Klara Kodra, *Për veprën e Akademikut Vasil S. Tole, “Kadare dhe Muzika”*

[<http://www.shqiperia.com/blog/per-vepren-e-akademikut-vasil-s-tole-kadare-dhe-muzika/>]

Dorian Koçi, *Shtegtimi i tingujve muzikorë në veprën letrare të Kadaresë*

[<http://www.gazetadita.al/shtegtimi-i-tingujve-muzikore-ne-vepren-letrare-te-kadarese/>]

Afrim Shabani, *Kadare dhe Muzika, te germosh dosjen-h*

[<http://gazetashqiptare.al/2020/08/28/kadare-dhe-muzika-te-germosh-dosjen-h/>]